



REPUBLIKA E SHQIPERISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**  
**DEKANI**

Tiranë, më 30.10.2023

**NJOFTIM PUBLIK**

Në datën 27.10.2023, **gjatë transmetimit të një emisioni investigativ**, janë konstatuar informacione të pasakta në lidhje me aplikimin e një kandidateje në Programin e Ciklit të Dytë të Studimit, **Master Profesional RESTAURIM MONUMENTESH KULTURE (MPRMK)**, pranë FAU.

Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, UPT, sqaron opinionin publik se kriteret e pranimit të kandidatëve në Programin e Ciklit të Dytë të Studimit MPRMK për vitin akademik 2023- 2024<sup>i</sup> janë përcaktuar në Vendimin nr. 1 datë 25.01.2022.

Në bazë të këtyre kriterëve:

1. Kandidatët, duhet të jenë diplomuar në Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë, në Arkitekturë, ose në Programet e Studimit të Ciklit të Parë, dhe/ose të Ciklit të Dytë në Arkitekturë dhe Inxhinieri Ndërtimit (Inxhinier Ndërtimi).
2. Kandidatët, të cilët janë diplomuar jashtë vendit në programet e studimit të përmendura më sipër, duhet të kenë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për Arsimin e Lartë të shtetit Shqiptar.

Kandidatja, e cila i është drejtuar emisionit investigativ:

1. është diplomuar në Arte Pamore (Grafikë) nga Akademia e Arteve të Bukura, në Firence, Itali më 17.03.2017. **Komisioni i vlerësimit ka vendosur që kandidatja nuk plotëson kriteret 1 dhe 2, pasi formimi i saj është Arte Pamore, Grafikë bazuar kjo në vërtetimin e njohjes dhe njehsimit të diplomës nga QSHA.**
2. është lejuar të aplikojë në sekretarinë mësimore pas këmbënguljes së saj që shqyrtimi i dosjes të kryhej nga komisioni i vlerësimit. **Sqarojmë që procesi i aplikimit është krejt i ndryshëm nga procesi i regjistrimit, i cili kryhet pasi kandidati shpallet fitues nga komisioni i vlerësimit.**
3. **ka dorëzuar dokumentet e aplikimit me mangësi.** Në dosjen e aplikimit mungon kopja e diplomës së njehsuar me origjinalin dhe suplementi i diplomës, dokumente këto të cilat kërkohen sipas Kreut IV/4, pika 8 dhe 9 të Udhëzimit të MAS nr.17 datë 30.7.2019<sup>ii</sup>. Aplikantja ka dorëzuar vetëm fotokopje të njehsimeve të diplomës Bachelor me 184 kredite dhe fotokopje të njehsimeve të diplomës/dëftesës e shkollës së mesme me notë mesatare të të gjitha viteve 7.26.

Kandidati i dytë fitues<sup>iii</sup> i përmendur në emisionin investigativ, **zotëron një diplomë Master i Shkencave në Arkitekturë** nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (Albanian University<sup>iv</sup>) **në përputhje të plotë me kriteret e pranimit.** (bashkëngjitur diploma e rastit në fjalë)

Gjejmë rastin të sqarojmë se **programi i studimit Master Profesional RESTAURIM MONUMENTESH KULTURE (MPRMK)** është thellësisht teknik, merret me restaurimin e objekteve ndërtimore e për rrjedhojë kërkon formim në programe politeknike. Ky program studimi është i ndryshëm nga programet e tjera të cilat lidhen me restaurim i artit pamor dhe ikonave



REPUBLIKA E SHQIPERISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**  
**DEKANI**

Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Universiteti Politeknik i Tiranës, beson në mirëkuptimin e këtij qëndrimi dhe e konsideron median si partnere të rëndësishme në funksion të transparencës dhe të rritjes së besimit të publikut tek institucionet e arsimit të lartë.

**DEKANI**

- 
- <sup>i</sup> [https://fau.edu.al/wp-content/uploads/2023/08/DRTA\\_MPRMK\\_Kriteret-e-pranimit-te-studenteve\\_2023-2024.pdf](https://fau.edu.al/wp-content/uploads/2023/08/DRTA_MPRMK_Kriteret-e-pranimit-te-studenteve_2023-2024.pdf)  
<sup>ii</sup> <https://fau.edu.al/wp-content/uploads/2019/08/Udh%C3%ABzim-nr.17-dat%C3%AB-30.7.2019.pdf>  
<sup>iii</sup> [https://fau.edu.al/wp-content/uploads/2023/10/DRTA\\_MPRMK\\_Lista-fituese-e-studenteve\\_2023-2024.pdf](https://fau.edu.al/wp-content/uploads/2023/10/DRTA_MPRMK_Lista-fituese-e-studenteve_2023-2024.pdf)  
<sup>iv</sup> <https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike/>